



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:239164  
Datë: 04.11.2024  
Numri i dokumentit: 06398382

K.Dh.Sh.II.nr.1939/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Faton Bajrami dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit/propozuesit "Megi Bau GMBH" SH.P.K, me numër unik identifikues 810506082, me adresë ne Barileve, rr. "Fatmir Leci", Komuna e Prishtinës, me pronar D.D., te cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve "Klinaku&Associates", kundër të paditurës /Kundërshtarit të Sigurimit: 1). Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), dhe 2). "Deshishku Contruction" SH.P.K, me seli ne Prishtine, me numër unik identifikues 810805773, me pronar H.D., me nr. personal ..., duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.428/2024 të datës 04.09.2024 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 31.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses "Megi Bau GMBH" SH.P.K, me numër unik identifikues 810506082, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.428/2024 të datës 04.09.2024 VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.428/2024 të datës 04.09.2024, është refuzuar si i pabazuar propozimi i paditëses "Megi Bau GMBH" SH.P.K, me numër unik identifikues 810506082, me seli në Prishtinë, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.2821 dt.16.07.2021, të nxjerr nga e paditura Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor përkitazi me kërkesëpadinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Me ankesë ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe Aktvendimin e Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.428/2024

të datës 04.09.2024 ta anulojë në tërësi si të pabazuar dhe lëndën ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 13 par. 6 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe Nenit 194 të LPK-së, dhe gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 02.09.2024, në Gjykatën Komerciale Departamenti për Çështje Administrative paditësi "Megi Bau GMBH" SH.P.K, me numër unik identifikues 810506082, me adresë në Barileve, rr. "Fatmir Leci", Komuna e Prishtinës, me pronar D.D., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve "Klinaku&Associates", kundër të paditurës /Kundershtaret i Sigurimit: 1). Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), dhe 2). "Deshishku Contruction" SH.P.K, me seli në Prishtinë, me numër unik identifikues 810805773, me pronar H.D., me nr. personal ..., me kërkesë padit për anulim të Aktvendimi i të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), me nr.2821, dt.16.07.2021, me propozim për shtyrje të vendimit të kundërshtuar. Paditësi në propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit ka deklaruar se me Aktvendim të Gjykatës Komerciale është lënë në fuqi Urdhri përmbarrimor P.nr.33/23, i dt.25.01.2023, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Destan Bujupaj, për ekzekutimin e dhunshëm të Aktvendimit të paditurës, me të cilin paditësi "Megi Bau GMBH" SH.P.K, detyrohet t'i paguaj gjobën në shumen e përgjithshme prej 10,307.00 Euro.

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ i Gjykatës Komerciale me aktvendimin e atakuar KA.nr.428/2024 të datës 04.09.2024, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e paditëses "Megi Bau GMBH" SH.P.K, me numër unik identifikues 810506082, me seli në Prishtinë, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.2821 dt.16.07.2021, të nxjerr nga e paditura Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor përkritazi me kërkesëpadinë. Gjykata e Shkallës së parë në arsyet e aktvendimit të ankimuar ka theksuar se Gjykata vlerëson përfaqësuesi i paditësi përveç që ju ka referuar dispozitës ligjore dhe atë të Ligjit për procedurën kontestimore (nenit 299 dhe nenit 300), nuk ka dhënë asnjë argument e aq më pak të bazuar në prova se ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar me nr.2821, dt.16.07.2021, i të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se në rastin konkret i autorizuari i paditësit përpos përshkrimit faktik të rrethanave në padi, nuk ka dhënë asnjë arsye që lidhet me pretendimet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Me të drejtë gjykata e shkallës

së parë konstaton se përfaqësuesi i paditësi përveç që ju ka referuar dispozitës ligjore dhe atë të Ligjit për procedurën kontestimore (nenit 299 dhe nenit 300), nuk ka dhënë asnjë argument e aq më pak të bazuar në prova se ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar me nr.2821, dt.16.07.2021, i të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej.

Në një gjendje të tillë të çështjes Kolegji vie në përfundim se gjykata është e lidhur me thëniet në padi, enë rastin konkret kur kemi të bëjmë me shtyrje të ekzekutimit të vendimit padyshim që i takon palës, respektivisht të autorizuarit që të jep arsye të qarta lidhur me pretendimet se shtyrja do t'i sillte dëm të pariparueshëm palës paditëse. Ndonëse i autorizuari i paditësit i është referuar dispozitave ligjore të LPK-së të cilat i ka specifikuar, kjo gjykatë pa u kufizuar në mënyrë strikte formale në referimet në LPK, megjithatë ka shqyrtuar kushtet ligjore nga Neni 22 i LKA-së i cili zbatohet në rastin konkret, mirëpo gjeti se pala nuk ka arsyetuar dhe as nuk ka dhënë argumente konkrete se përse akti i atakuar në rastin konkret do të ishte me ndikim të dëmshëm për palën. Kolegji vie në përfundim se pretendimet e bazuara në prova i takojnë palës dhe gjykata nuk ka tagër që ex-officio të trajtojë nëse akti i kontestuar i sjell dëm palës.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk është vërtetuar se cilat pretendime janë ato që do të mund të sillnin deri te plotësimi i kushteve për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së,u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e shkallës së dytë  
Kom.Dh.shk.II.nr.1939/2024, me datë 31.10.2023

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari  
Dren Rogova